



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI BASHKIAK KUÇOVË

### FUNKISONET DHE DETYRAT E STRUKTURAVE KOMUNITARE

- a. Të shërbejnë si zë, të organizojë pjesëmarrjen dhe të mbështesë agnazhimin e komunitetin me procesin e politikëbërjes dhe vendimmarrjes së Bashkisë që i ndikon banorëve, biznesve dhe territorit të lagjes/fshatit.
- b. Të nxisë dhe të lehtësojë pjesëmarrjen e komunitetit në procesin e konsultimeve publike për politikën dhe vendimmarrjen e qeverisë bashkiake.
- c. Të nxisë dhe mbështesë ndërtimin e kulturës dhe praktikave të bashkëpunimit dhe komunikimit midis banorëve e bizneseve të lagjes/fshatit dhe të zgjedhurve dhe zyrtarëve bashkiakë.
- d. Të motivojë dhe mobilizojë rrjetëzimin, vullnetarizmin dhe kapitalin shoqëror në lagje/fshat për të kontribuar në rritjen e mirëqënjes dhe zhvillimin e territorin e lagjes/fshatit.
- e. Të kontribojë në eliminimin e përjashtimit social të grupeve vulnerabël nga procesi i politikëbërjes dhe vendimmarrjes së qeverisë bashkiake.
- f. Këshillojnë qeverinë bashkiake në lidhje me çështjet që i ndikojnë komuniteti, biznesit dhe territorit të fshatit/lagjes.
- g. I sigurojnë qeverisë bashkiake opinione, propozime, komente të komunitetit të lagjes/fshatit për vendimmarrjen e qeverisë bashkiake.
- h. Përfaqësojnë interesat e grupeve të interesit të lagjes/fshatit pranë qeverisë bashkiake dhe aktorëve të tjerë dhe percjellin interesat dhe nevojat e komunitetit dhe grupeve të interesit në territor tek organet e Bashkisë.
- i. Shërbejnë si grup këshillimit dhe monitorimi për investimet e bëra në fshat/lagje nga Bashkia apo aktorë të tjerë qeveritarë dhe jo-qeveritar.
- j. Nxisin dhe mbështesin bashkëpunimin midis komunitetit dhe OJF-ve.
- k. Mundësojnë dhe lehtësojnë qasjen në informacione dhe të dhëna që administrohen nga Bashkia apo agjencie të tjera qeveritare, të cilat i shërbejnë komunitetit dhe punës së Strukturës Komunitare.
- l. Rrisin besimin tek strukturat komunitare si struktura të cilat përfaqësojnë interesat e drejtpërdrejta të komunitetit dhe zbusin polarizimin politik dhe social në komunitet.
- m. Nxisin dhe mbështesin bashkëjetesën dhe harmoninë në komunitet.
- n. Mbështesin iniciativat komunitare me qëllim kultivimin e kulturës të bashkëpunimit dhe bashkëqeverisjes me qeverinë bashkiake.
- o. I paraqesin Këshillit Bashkiak dhe Kryetarit të Bashkisë një listë vjetore të përparësive për lagjen apo fshatin për t'i shqyrtuar dhe përfshirë në buxhetin e Bashkisë. Kryetari i Bashkisë do të informojë Strukturë Komunitare për afatin e fundit për dorëzimin e listës, në mënyrë që kontributi të konsiderohet në kohën e duhur. Periudha e dorëzimit të propozimeve data\_\_\_ e muaji \_\_\_\_\_.

- p. Zhvillojnë takime periodike me zyrtarë përgjegjës të drejtorive të Bashkisë për problematika në lidhje me sasinë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike në territorin e lagjen apo fshatit.
- q. Mbrojnë interes e bashkësitë e tyre kundrejt Bashkisë për çështje të rëndësishme si zhvillimi, të pastrehët dhe njerëzit në nevojë, kontrolli i territorit dhe gatishmëria për përballimin e emergjencave.

**Shënim:** Për të mësuar më shumë rreth Strukturave Komunitare, mund të lexoni rregulloren e Strukturave Komunitare që gjendet në faqen **web** të Këshillit, në rubrikën *Rregulloret e Këshillit Bashkiak Kuçovë*.